



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 QERSHOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 12.
JUNA 2008. GODINE

QERSHOR – JUNI
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të pestë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpërbërjen e Trupave Mbrojtje të Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale,
- 1.4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës,
- 1.5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Minerat në Kosovë,
- 1.6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave,
- 1.7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
- 1.8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë,
- 1.9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet publike dhe
- 1.10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2008.

D n e v n i r e d:

2. Prvo razmatranje Pete Grupe Nacrta Zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:

- 1.1. Prvo Razmatranje Nacrta Zakona o Raspuštanju Kosovskog Zaštitnog Korpusa
- 1.2. Prvo Razmatranje Nacrta Zakona o Službi u Bezbednosnim Snagama Kosova
- 1.3. Prvo Razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2006/50 o Rešavanju Zahteva koji e Odnose na Privatnu Nepokretnu Imovinu, Uključujući Poljoprivrednu i Komercijalnu Imovinu
- 1.4. Prvo Razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2005/20 o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2001/35 o Penzijskom Fondu Kosova
- 1.5. Prvo Razmatranje Nacrta Zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2005/2 o Uspostavljanju Nezavisne Komisije za Rudnike i Minerale

- 1.6. Prvo Razmatranje Nacrta Zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2004/49 o Aktivnostima Pružanja Usluga Vodosnabdevanja, Kanalizacije i Odnosa Smeća
- 1.7. Prvo Razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Uredbe UNMIK-A 2003/16 o Proglašenju Zakona o Telekomunikacijama koji je Usvojila Skupština Kosova
- 1.8. Prvo Razmatranje Nacrta zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Skupštine Kosova 2004/9 o Regulatoru Energije
- 1.9. Prvo Razmatranje Nacrta zakona o Javnim Preduzećima
- 1.10. Prvo Razmatranje Nacrta zakona o Izmeni UNMIK Uredbe 2008/13 o Usvajanju Konsolidovanog Budžeta Kosova i Autorizovanih Rashoda za Periodu 1 januar do 31 decembra 2008.

A g e n d a:

1. First reading of the fifth's Group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's Proposal, based on the Special procedure:

- 1.1. First reading Draft Law on Dissolution of the Kosovo Protection Corps,
- 1.2. First reading Draft Law on Service in the Kosovo Security Force,
- 1.3. First reading Draft Law on amending UNMIK Regulation 2006/50 on the Resolution of Claims Relating to Private Immovable Property, Including Agricultural and Commercial Property,
- 1.4. First reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation 2005/20 Amending UNMIK Regulation 2001/35 on Kosovo Pensions Trust,
- 1.5. First reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation No. 2005/2 on the Establishment of the Independent Commission for Mines and Minerals,
- 1.6. First reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation 2004/49 on the Activities of Water, Wastewater and Waste Services Providers,
- 1.7. First reading Draft Law on Amending UNMIK Regulation No. 2003/16 on the Promulgation of a Law adopted by the Assembly of Kosovo on Telecommunications,
- 1.8. First reading Draft Law on Amending Kosovo Assembly Law No. 2004/9 on the Energy Regulator,
- 1.9. First reading Draft Law on Publicly Owned Enterprises,
- 1.10. First reading Draft Law on Amendment of UNMIK Regulation No. 2008/13 on the approval of the Kosovo Consolidated Budget and Authorizing Expenditures for the period 1 January to 31 December 2008.

Seancën plenare e kryesoi Kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm mbi 85 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë të datës 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2008, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Po ashtu, shoh të nevojshme që t'ju njoftoj se projektligjet e shtruara për shqyrtim me procedurë të veçantë kanë të bëjnë me grupin e ligjeve të identifikuara me Pakon e Ahtisarit, grupin e ligjeve që ndërlidhen me Pakon e Ahtisarit dhe grupin e ligjeve nga përgjegjësitë e UNMIK-ut.

Rendi i ditës, së bashku me materialin, iu janë shpërndarë deputetëve, prandaj fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

Në sallë janë të pranishëm 88 deputetë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Sot, në këtë seancë, para jush paraqes Projektligjin për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, i cili Projektligj është sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Ky projektligj parasheh shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës brenda një viti, nga data e përfundimit të periudhës së tranzicionit, në pajtim me Propozimin gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës.

Para miratimit të tij, në Grupin punues gjithëpërfshirës, ky projektligj iu është ofruar për komente dhe sugjerime të gjithë faktorëve pjesëmarrës dhe relevantë, duke përfshirë Qeverinë, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, NATO-n, Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe OSBE-në.

Projektligji përcakton mandatin dhe autoritetin ekzekutiv mbi TMK-në gjatë periudhës së shpërbërjes. I referohet bartjes së detyrave kyçe tek Forca e Sigurisë së Kosovës, si dhe përcakton ofrimin e të gjitha mjeteve për realizimin e shpërbërjes në pajtim me dispozitat e përcaktuara me këtë projektligj.

Deri në shpërbërjen e TMK-së, prania ushtarake ndërkombëtare, në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar dhe me Qeverinë e Kosovës, ushtron autoritet ekzekutiv mbi TMK-në dhe vendos për programin kohor të shpërbërjes së saj.

Kjo, fillimisht kryhet përmes Zyrës së Koordinatorit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që bashkëpunon me praninë ndërkombëtare ushtarake rreth çështjeve që i përkasin shpërbërjes së TMK-së.

Ky projektligj, ndër të tjera, parasheh dhe planifikon edhe mbikëqyrjen e transferimit të pasurive të Trupave Mbrojtëse të Kosovës tek Forca e Sigurisë së Kosovës, si dhe kompetencën e Kuvendit të Kosovës për ushtrimin e mbikëqyrjes demokratike e parlamentare mbi TMK-në deri në shpërbërjen e saj.

Pjesëtarët e TMK-së, të cilët përmbushin kriteret, kanë të drejtë aplikimi për të shërbyer në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe, po ashtu, ata do të kenë të drejtë në përfitimin e pensioneve, të cilat rregullohen me ligj të veçantë, të drejtë në paketën e shkurtimit nga puna në programin e riintegrit.

Me qëllim të realizimit të obligimeve të përcaktuara me nenin 154 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Aneksit 8 të Propozimit gjithëpërfshirës, propozoj miratimin e këtij projektligji, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të paraqitur për fjalë, sipas asaj që shoh në ekran, nga shefat e grupeve parlamentare nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votim, në parim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 4 “kundër” dhe 12 abstenime – miratohet, në parim, Projektligji për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës, t’i paraqesë Kuvendit raportin, me rekomandime.

Ju njoftoj se tani në sallë janë 90 deputetë.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin në Forcën e Sigurisë të Kosovës

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

RAMË MANAJ: I nderuar Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë dhe ministra,
Edhe Projektligji për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës është Projektligj i sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës.

Ky projektligj rregullon shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke përfshirë rregullat dhe kushtet e shërbimit për të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Para miratimit të tij, në Grupin gjithëpërfshirës, Projektligji iu është ofruar për komente e sugjerime të gjithë faktorëve pjesëmarrës dhe relevantë, Qeverisë, Trupave të Mbrojtjes së Kosovës, NATO-s, Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe Organizatës së Sigurisë dhe të Bashkëpunimit Evropian.

Ky është një draft gjithëpërfshirës, i cili përfshin dispozitat e përgjithshme, të drejtat dhe obligimet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, rolin e pranisë ndërkombëtare ushtarake në themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe çështjet specifike lidhur me pranimin e ish pjesëtarëve të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ky projektligj, i cili respekton standardet e NATO-s dhe, do të thosha, i përmbush ato, i referohet edhe rregullimit të çështjeve, përfshirë uniformat, emblemat, parametrat e shërbimit, strukturat e karrierës, vlerësimet vjetore, promovimet, emërimet, kodin e mirësjelljes, kodin disiplinor, pagat, pagesat shtesë, orarin e punës, ndërprerjen e shërbimit dhe çështje të tjera.

Dispozitat e këtij projektligji janë kryesisht të përgjithshme për arsye se këto do të kompletohen me rregullore të veçanta, që do të jenë së paku 30 rregullore të tilla, të cilat do të hartohen nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës prej momentit të fillimit të funksionimit të saj.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të parapara me dispozitat e Kushtetutës dhe të Propozimit gjithëpërfshirës, ju propozoj ta miratoni edhe këtë projektligj, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ramë! Për fjalë është paraqitur shefi i Grupit të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Para nesh po shtrohet një çështje që duhet ta votojmë, diçka që për herë të parë po e shohim dhe nuk do ta anashkaloj faktin e të them se këto ligje, të cilat ne po i shqyrtojmë tash dhe votojmë për to, në të vërtetë dhe me plotë të drejtë, po na quajnë edhe makinë e votimit, sepse, po më duket, jemi thjeshtësuar më tepër sesa vetë...

KRYETARI: Të lutem, flisni lidhur me temën dhe lidhur me Projektligjin.

IBRAHIM MAKOLLI: Po, zoti Kryetar! Nëse më lejoni të flas...

KRYETARI: Ju lutem! Të lejoj, por mund të flisni për rendin dhe pikën e rendit të ditës.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti, Kryetar! Propozimi im është që këto draftligje t'i miratojmë në paket, sepse, edhe ashtu, asnjë prej deputetëve nuk i ka parë. Këto i kemi parë sot para nja 20 minutash dhe secili prej nesh i kemi marrë, prandaj po flasim për diçka për të cilën, asnjëri prej nesh nuk e di se çka përmbajnë.

Pavarësisht kësaj, unë kujtoj se ky Kuvend njëherë e përgjithmonë duhet, pavarësisht asaj se duhet miratuar para datës 15 qershorit, sepse shumë mirë e dini se kjo seancë është thirrur në orën 13 për në orën 15 dhe asnjë prej këtij dokumentacioni që ne po e shqyrtojmë, nuk e kemi pasur para veti. Po kërkon diçka prej nesh për t'u deklaruar për diçka që asnjëri prej nesh nuk e kemi parë. Kujtoj se nuk është mirë të vijmë në një pozitë të këtyllë ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Të paraqitur për fjalë, nuk ka.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Kush nuk ka kartelë? Kush është “për” pa kartelë...

Një, dy. Ju faleminderit!

Kush është “kundër” që nuk ka kartelë? Një.

Me 73 vota “për, 5 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t'ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me**

**pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore
dhe atë komerciale**

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15. shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj Ministrin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari kryetar i Parlamentit,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,

Para jush sot e paraqes Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Ky Ligj ka për qëllim zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, pa i referuar kërkesat e tilla në gjykatat me kompetencë territoriale dhe lëndore

Sipas këtij Ligji, Agjencia Kosovare e Pronës do të funksionojë si Agjenci e pavarur në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës. Agjencia Kosovare e Pronës do të përbëhet nga Bordi mbikëqyrës, nga Sekretaria ekzekutive dhe nga Komisioni për Kërkesa Pronësore. Me qëllim të bartjes së kompetencave të kësaj fushe tek autoritet vendore të Republikës së Kosovës, si dhe të përmbushjeve të obligimeve që dalin nga dispozitat e përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës dhe të neneve 4 dhe 5, Aneksi 7 të Propozimit gjithëpërfshirës, propozoj miratimin e këtij Projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Shefat e grupeve nuk janë të gatshëm ta marrin fjalën. Në vazhdim, kërkoj deklarinimin tuaj. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

A ka “për” pa kartelë: 2. “Kundër”: 1, Abstenim, nuk ka,

Me 74 vota “për”, 5 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin, në parim.

Në bazë të Vendimit të 15 shkurt, Komisioni ad-hoc ngarkohet që në seancën e radhës Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës**

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15. shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të këtij Ligji, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

RAMË MANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,
I nderuari Kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Deputetë dhe ministra të nderuar,

Projektligji për Fondin Pensional të Kosovës parasheh delegimin e kompetencave nga UNMIK-u tek autoritet vendore me qëllim të ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësi lidhur me Fondin e kursimeve pensionale.

Fondi i kursimeve pensionale i Kosovës, në këtë Projektligj do të funksionojë si subjekt i pavarur juridik nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, e cila është organ i pavarur në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës.

Fondi ka për detyrë menaxhimin dhe administrimin e llogarive individuale të pensioneve. Vendosja e politikës ekonomike lidhur me pensionet si pjesë e politikës buxhetore dhe fiskale, është përgjegjësi e Qeverisë. Qeveria e realizon këtë politikë përmes Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Guvernatori i Bankës Qendrore dhe anëtarët e tjerë të emëruar nga Kryeministri, do të përbëjnë Grupin punues ndërministror për politikën e pensioneve.

Në bazë të dispozitave të këtij Projektligji, Kuvendi i Republikës së Kosovës, emëron anëtarët e Bordit drejtues, njëri prej të cilëve do të jetë anëtar ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Në fund, duke marrë parasysh, në radhë të parë, rëndësinë e këtij Projektligji për mbushjen e obligimeve që dalin nga Kushtetuta dhe Propozimi gjithëpërfshirës, dhe me qëllim të funksionimit sa më efikas të Fondit Pensional, propozoj miratimin e këtij Projektligjit, në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

“Për” me ngritje dore 2, “kundër” me ngritje dore 1, abstenim, nuk ka. Do të thotë, 82 vota janë “për”, 5 “kundër”, 4 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-it, nr. 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pika e pestë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Minerale në Kosovë.**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministren, zonjën Justina Pula, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

JUSTINA PULA: I nderuar Kryetar i Kuvendit,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Sot para jush ndodhet Projektligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/2, për themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i cili kërkohet të shndërrohet nga Rregullorja e UNMIK-ut në ligj të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj përmban gjithsej 11 nene dhe fokusohet në bartjen e kompetencave nga UNMIK-u në Komisionin e Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve.

Ju ftoj që ta miratoni, në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm shefat e grupeve parlamentare.
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Kush është “për” pa kartelë? “Për” janë 3, “kundër” 1, do të thotë më 77 vota “për”, 5 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet në parim Projektligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/2 për themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Minerale në Kosovë.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/49 për veprimtarisë e ofruesve të shërbimeve: të ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave.**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MAHIR YAGCILAR: Edhe një herë ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Para jush prapë paraqes një projektligj, i cili ka të bëjë me ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/49 për veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të: ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave. Me këtë ligj themelohet Zyra Rregullative e Ujësjellësit dhe e Mbeturinave si një organ i pavarur në pajtim me nenin 119 dhe 142 të Kushtetutës. Me qëllim të bartjes sa më të efektshme të kompetencave dhe të përgjegjësiave tek autoritetet vendore të Kosovës, në momentin e përfundimit të periudhës së tranzicionit, propozoj miratimin e këtij projektligji në këtë përbërje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim!

Votojmë tash:

Kush është “për” me ngritje dore? 2. Mirë, ju faleminderit!

Kush është “kundër” me ngritje dore? 1.

Me 77 vota “për”, 4 ”kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të: ujësjellësit, të kanalizimit dhe të mbeturinave.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e radhës është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/16, për shpalljen e Ligjit për telekomunikacionin, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.**

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin, Fatmir Limaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuari Kryetar,

Zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, Projektligji për telekomunikacion nuk ka ndryshime nga ai që është në fuqi të cilin e ka miratuar ky Parlament në përbërjen e kaluar, përveç se këtu tash ka një lloj spastrimi, nëse mund ta quaj kështu, teknik, i cili praktikisht mundëson bartjen e kompetencave nga UNMIK-u në Qeverinë e Kosovës. Pra, është bërë një spastrim

teknikisht nga Rregullorja e UNMIK-ut me dy lëshime teknike, të cilat ne i kemi paraqitur para Qeverisë dhe Qeveria i ka votuar, prandaj propozoj që edhe këtu të njëjtën gjë t'ju propozoj juve si deputetë.

Meqë jemi në fazën e njohjes ndërkombëtare të vendit tonë nevojitet edhe njohja në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, prandaj, ne mendojmë, siç është rasti me ITU dhe me institucionet e tjera, normalisht që nesër të anëtarësohemi, të lidhim marrëveshje bilaterale dhe multilaterale. Pra, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit duhet të ketë autorizime në këtë drejtim,

Prandaj, në nenin 11 që i referohet neni 3.5 të Ligjit për komunikacion të formulohet si në vijim:” Ministria autorizohet që të lidhë marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me organizata ndërkombëtare në fushën e telekomunikacionit”

Po ashtu, edhe një nen tjetër është. Ne kemi kërkuar dhe është miratuar në Qeverinë e Kosovës edhe ky lëshim tjetër që neni 13 të fshihet plotësisht dhe të mbetet neni 19 ashtu si ka qenë në ligjin e vjetër. Me këto dy plotësime ju ftoj, të nderuar deputetë, që ta votojmë këtë projektligj, i cili, dua të them përsëri, nuk ndryshon nga ligji i kaluar e që ne mendojmë në strategjinë legjislative të Ministrisë së Transportit duhet një ligj tjetër për telekomunikacion, ku së bashku ekspertët e Ministrisë dhe ata ndërkombëtarë do të hartojnë një ligj tjetër që do t'i përshtatet kohës dhe, besoj, diku nga tetori në strategjinë legjislative do të jetë një ligj i ri për telekomunikacion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Faleminderit, ministër!

Vetëm një sqarim, ju paraqitët amendamente në leximin e parë apo konfirmuat ndryshimet që i bartin prej rregulloreve? Faleminderit!

KRYETARI: Pasi që nuk kemi të paraqitur tjerë për diskutim, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Kush është “për” me ngritje dore? 2, “kundër” me ngritje dore 1, abstenim nuk ka. Konstatohet se me 78 vota “për”, 4 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për telekomunikacionin, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e ministrit.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e tetë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008 janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministren, zonjën Justina Pula, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA JUSTINA PULA: Faleminderit, zoti Kryetar i Parlamentit!

Ky ligj në fakt ekziston që nga qershori i vitit 2004. Ka disa ndryshime sa i përket neneve në kuadër të këtij ligji dhe kjo ka të bëjë me bartjen e kompetencave nga UNMIK-u, respektivisht nga PSSP-ja- në institucionet e Republikës së Kosovës.

Ju ftoj që ta aprovoni, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për prezantimin e shkurtër!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Kush është “për” me ngritje dore? 2, “kundër” 1, abstenim nuk ka.

Konstatohet se me 76 vota “për”, 5 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë

Në bazë të vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet publike

Në bazë të vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit!

I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Zëvendëskryeministër,

Kam nderin që para jush ta paraqes Projektligjin për ndërmarrjet publike, i cili është debatuar edhe në Grupin Strategjik edhe në Grupin Gjithëpërfshirës. Ky ligj parasheh që transferi i ndërmarrjeve publike të bëhet konform Pakos së Ahtisarit që ndërmarrjet publike të kthehen në menaxhim të Qeverisë së Kosovës. Prona e ndërmarrjeve publike edhe me Kushtetutë është përcaktuar si pronë e Republikës së Kosovës. Konsideroj se janë paraqitur të gjitha elementet më të avancuara të standardeve të qeverisjes ... konform OECD-së dhe në bashkëpunim edhe me këshilltarët ndërkombëtarë dhe vendorë pas

kalimit nëpër të gjithë filtrat edhe pse ka disa nene të cilat, mbase, në rrethanat tjera nuk do të duhej të ishin, megjithatë lus dhe propozoj që ky ligj të aprovohet dhe të ecim në procedurë, në mënyrë që më datën 15 të jemi në gjendje t'i transferojmë ndërmarrjet publike në qeverisje të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ministër!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Kush është “për” me ngritje dore? 2. “Kundër”? Faleminderit!

Konstatohet se me 60 vota “për”, 10 “kundër” dhe 10 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndërmarrjet publike.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/13 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008**

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të 15 shkurtit 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij, në parim.

Ftoj ministrin, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit!

I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Ky ligj, në fakt, është një proces i pastrimit të attributeve që i kanë pasur deri më tani institucionet ndërkombëtare të rezervuara, si dhe institucionet e tjera, të cilat me ndryshimin e statusit të Kosovës, pra të Republikës së Kosovës, do të kalojnë në kompetenca tona. Pra, ka elemente, kryesisht, teknike, aty ku shkruan PSSP-ja, do të jetë Kuvendi i Kosovës, ku shkruan AKM-ja- do të jetë Agjencioni i Privatizimit të Kosovës. Ku është ndonjë institucion tjetër që ka qenë pjesë e rezervuar, do të mbeten institucionet e Kosovës, dhe në parim ka kaluar nëpër të gjithë filtrat, nëse mund të them, është aprovuar dhe kërkoj nga ju dhe nga të gjithë të pranishmit ta aprovojmë, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për ekonomizimin e kohës!

Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc, zotin Fehmi Mujota ta marrë fjalën.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, në fakt, nuk kam diçka të shtoj për Projektligjin e sapo prezantuar, por kam një kërkesë publike për të gjithë ministrat dhe ministritë përkatëse që amendamentet që ata mendojnë se mund të bëjnë punë për plotësimin e këtyre rregulloreve që do të shndërrohen në ligj, t'i sjellin deri në orën 9,00 të ditës së nesërme, në mënyrë që Komisioni të mund të punojë në mënyrë korrekte dhe të drejtë me këto çështje. Kjo kërkesë vlen edhe për deputetët, individualisht, dhe për grupet parlamentare, nëse kanë amendamente edhe për ligjet e tjera, në mënyrë që të jemi sa më korrekt me kohën që e kemi shumë të shkurtër për punë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Askush tjetër s'e ka kërkuar fjalën.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Kush është "për" me ngritje dore? 2. Mirë, "kundër" nuk kemi kësaj radhe.

Konstatohet se me 74 vota "për", 3 "kundër" dhe 8 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/13 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën 1 janar 31 dhjetor 2008.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t'ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Seanca do të mbahet nesër në orën 16,00.

Mirupafshim!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve